



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-069

Prishtinë, më 25 qershor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 25 QERSHOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja, Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15 qershor 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

Në fillim të mbledhjes, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci deklaroi se e tërheqin mocionin të adresuar në Nën-komisionin për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit lidhur me pretendimet e shkeljeve procedurale të zbatimit të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen plenare të mbajtur më 22 qershor 2012.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 qershor 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 qershor 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të premten, më 28 qershor 2012, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Votimi i Raportit të punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, për vitin 2011,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësi,
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,
9. Formimi i Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Formimi i Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e cekur më lart, këtë pikë e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare të datës 28 qershor 2012, si dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit, që deri në seancën e radhës, më 28 qershor 2012, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.

2. Përbërja e Komisionit duhet të jetë: GP i PDK-së, 2 anëtarë, GP i LDK-së, 2 anëtarë, GP i VV, 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP i KKR-së, 1 anëtar, GP i SLS-së, 1 anëtar dhe GP 6+ , 1 anëtar.

Pika shitesë

1. Vizita e Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Bamir Topi

Kryetari i njoftoi të pranishmit për vizitën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi, që do ta realizojë më 29 qershor 2012, në Republikën e Kosovës.

Me këtë rast, Kuvendi do të mbajë seancë solemne, më 29 qershor 2012, në të cilën Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi, me një fjalë rasti do t'u drejtohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:20** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale